# DËSHMI ARKIVI

**A-456203**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kuvendi i Mitrovicës miraton Deklaratën "Jo në emrin tim" për aktgjykimin ndaj krerëve të UÇK-së |
| ADRESA | `https://tpz.al/kuvendi-i-mitrovices-miraton-deklaraten-jo-ne-emrin-tim-per-aktgjykimin-ndaj-krereve-te-uck-se-i333299` |
| BURIMI | tpz.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 18:40:53 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 18:30:29 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bc29d3199e984a644ea6d38eb3028f1bffbaeca358445ea938b7ec486153e1e7` |
| TEKSTI | `016c1938427a319e8d5fa0bf438099292b44e7d193ff89a8eff4cc09ffce566a` |
| PAMJA | `c1e59d7313181c7785666968cdfa545bc9b351787c1f04bd6b19bf5f1be60b7a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `30d678d7df27455e22df32c49969eef4631ef44156ebeb5aad2ae38bb0347e7a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `214493168e8eaddb39b9693f5adfa0b73b0dd908a9438af0217b4721b8b2f352` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/30d678d7df27455e22df32c49969eef4631ef44156ebeb5aad2ae38bb0347e7a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BALLKAN, 18 SEPTEMBER 2026, 20:30

# Kuvendi i Mitrovicës miraton Deklaratën "Jo në emrin tim" për aktgjykimin ndaj krerëve të UÇK-së

TPZ



Me 28 vota për, Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Jugut ka miratuar sot deklaratën lidhur me aktgjykimin e shkallës së parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.

Në seancë mungoi kryetari i Komunës, Faton Peci.

Në deklaratë shprehet mospajtimi me aktgjykimin e shpallur më 16 shtator 2026 nga trupi gjykues i Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Më tej theksohet se për një dënim penal të kësaj peshe, përgjegjësia personale e secilit të akuzuar duhet të provohet me prova të qarta, konkrete dhe bindëse, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Në deklaratë thuhet gjithashtu se përgjegjësia penale individuale nuk duhet të ndërtohet mbi supozime, përgjithësime, dëshmi të tërthorta apo lidhje të nxjerra nga pozitat politike dhe ushtarake që individët kanë mbajtur gjatë luftës.

Deklarata është lexuar para anëtarëve të Kuvendit nga shefi i Grupit të PDK-së, Shkëlqim Ibrahimi, i cili ka paraqitur qëndrimin e këtij kuvendi lidhur me aktgjykimin.

"Standardi më i lartë i provueshmërisë penale shpreh mospajtimin e thellë me atë gjykim të shkallës së parë të Dhomave të Specializuara nga trupi gjykues, të datës 16 shtator 2026, ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, zotit Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Kuvendi konsideron se për një dënim penal të kësaj peshe, përgjegjësia personale e secilit të akuzuar duhet të provohet me prova të qarta, konkrete, bindëse dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Kuvendi shpreh shqetësimin se përgjegjësia penale individuale nuk duhet të ndërtohet mbi supozime, përgjithësime, dëshmi të tërthorta apo mbi lidhjet e nxjerra nga pozita politike, ushtarake dhe ushtarake që individët kanë mbajtur gjatë luftës. Kuvendi vlerëson se vetë trupi gjykues ka shpallur të akuzuarit të pafajshëm për akuza për krime kundër njerëzimit, pasi është konstatuar se Prokuroria nuk ka arritur të provonte përtej

ide!

Vendimi i Hagës si moment reflektimi
Nga Ergys Mërtiri

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

Tej e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose kliko këtu për mënyra të tjera kontakti.

Messenger

Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

Shiko të tjera video

dyshimit të arsyeshëm ekzistencën e një sulmi të përhapur ose sistematik kundër popullatës civile. Po ashtu, pafajësi janë dhënë lidhur me një numër incidentesh të tjera të pretenduara. Për Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, kjo dëshmon rëndësinë themelore që standardi përtej dyshimit të arsyeshëm duhet të zbatohet me të njëjtin rigorozitet për çdo akuzë, çdo formë përgjegjësie dhe secilin të akuzuar veçmas", u shpreh ai.

"Kuvendi konsideron se kur pas një procesi shumëvjeçar vërehen paqartësi serioze mbi lidhjen konkrete të individit me veprën penale, këto paqartësi nuk mund të mbulohen me perceptime, dëshmi indirekte apo përgjithësi të nxjerra vetëm nga hierarkia organizative. Kuvendi i Mitrovicës shpreh qëndrimin se, nëse përgjegjësia individuale e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm me prova bindëse dhe të drejta në lidhje me elementet përkatëse të veprave penale, statusi juridik duhet të ishte shpallja e tyre të pafajshëm", theksoi Ibrahimi.

"Në fund duhet të theksojmë se gjykimi i shkallës së parë nuk është fundi i procesit. Procedura e ankimit është pjesë e drejtësisë dhe ne duhet të shpresojmë që ato të shqyrtohen me kujdes, të gjitha pretendimet, provat dhe çështjet që lidhen me përgjegjësinë individuale. Duke pasur parasysh se vendimi u shpall me formulimin 'në emër të popullit të Kosovës', Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut përcjell mesazhin e qartë të qytetarëve të saj: 'Jo në emrin tim'. Kjo është shprehje e mospajtimit me këtë dënim dhe e të drejtës për të kërkuar drejtësi për udhëheqjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, zotin Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi", tha Ibrahimi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Jugut, Safet Kamberi, tha se Kuvendi shpreh solidaritet me familjet e ish-krerëve të UÇK-së dhe bëri thirrje për ruajtjen e qetësisë dhe unitetit.

"Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Jugore shpreh solidaritet me familjen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit, si dhe me të gjithë ata që këtë proces e kanë përjetuar me dhimbje dhe shqetësim. Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Jugore u bën thirrje qytetarëve të Mitrovicës dhe gjithë Kosovës që, përkundër dhimbjes dhe emocioneve të forta, të ruajnë qetësinë, dinjitetin dhe unitetin, duke shprehur qëndrimet e tyre në mënyrë paqësore dhe institucionale", tha Kamberi.

Më 16 shtator, katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u dënuan nga Gjykata Speciale. Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, Kadri Veseli me 18 vjet, ndërsa Rexhep Selimi me 13 vjet burgim.


BALLKAN / 18 September 2026, 19:57

"Pajisja regjistronte çdo të dhënë të pacientit!" – Vdekja e këngëtarit grek, dëshmia e sekretares së mjekut: E pashë dhe e përshëndeta Mazonakisin, deri kur ika nga puna...

BALLKAN / 18 September 2026, 18:33

Mali i Zi bën pagën minimale 1000 euro/ Nga janari 2027 nis "Euro Model"

BALLKAN / 18 September 2026, 16:49

Ish-ambasadori Bosch: Specialja nuk duhej të ekzistonte, vendimi ndaj Thaçit dhe ish-krerëve të UÇK-së skandaloz

BALLKAN / 18 September 2026, 15:40

Serbia hap fabrikën e dronëve izraelitë, Vuçiç: Do të furnizojmë edhe ushtri të tjera

BALLKAN / 18 September 2026, 15:32

Mediat serbe kryqëzojnë artisten Leonora Jakupi: Ajo po përkrah gjarprin, Hashim Thaçin!

BALLKAN / 18 September 2026, 13:32

"Fonde e ekspertë"/ Dënimi i ish-krerëve të UÇK, 4 kërkesat e protestuesve: Nga shfuqizimi i ligjit për Dhomat e Specializuara tek shkarkimi i Gërvallës

BALLKAN / 18 September 2026, 13:12

Kosova proteston kundër 'Speciales', Gucati-Kurtit: Largoje Gërvallën, ra pre e ndikimit të Serbisë! Bashkëpunoi me armikun

BALLKAN / 18 September 2026, 12:25

'Po tentoni të vrisni edhe njëherë popullin shqiptar'/ Dënimi i ish-krerëve të UÇK nga Gjykata Speciale, Prishtina në protestë

BALLKAN / 18 September 2026, 11:31

Prishtinë/ PDK pritet të dorëzojë sot në Kuvend nismën për ndryshimin e

BALLKAN / 17 September 2026, 21:29

Haxhiu: UÇK-ja nuk mbrohet duke shpallur kundërshtarët “spiunë” e “tradhtarë”

Ligjit për Gjykatën Speciale

BALLKAN / 17 September 2026, 20:26

Pamje të papublikuara nga bastisja e shtëpisë së Jakup Krasniqit, ishte edhe hetuesja e lidhur me dëshmitarin e paguar nga Serbia (VIDEO)

BALLKAN / 17 September 2026, 19:14

Djali i Kadri Veselit rrëfen momentet para dhe pas vendimit në Hagë: Nuk u frikësuam nga drejtësia, por nga politika!

BALLKAN / 17 September 2026, 18:36

Avokati i Thaçit: Do ta apelojmë aktgjykimin, janë bërë gabime të rëndësishme ligjore. Mesazhi i ish-presidentit të Kosovës

BALLKAN / 17 September 2026, 18:09

REL: Aktgjykimi i Hagës ndaj katër ish-udhëheqësve të UÇK-së përballë historisë së luftës së Kosovës

BALLKAN / 17 September 2026, 17:52

Kurti takim me kreun e PDK pas verdiktit të Hagës: Vendimi duhet të përmbyset në Apel

BALLKAN / 17 September 2026, 16:25

FAZ ngre pikëpyetje për dënimet ndaj ish-krerëve të UÇK-së: A janë proporcionale me ato të kriminelëve serbë të luftës?

BALLKAN / 17 September 2026, 15:45

"Një njeri i zakonshëm nuk

BALLKAN / 17 September 2026, 15:24

Gjykata Speciale, Hamza


mund ta ketë atë buzëqeshje pas atij vendimi"/ Përlotet vajza e Jakup Krasniqit: Ja mesazhi që na ka lënë

paralajmëron hapa konkretë: Do të takohem me liderët politikë, PDK ka gati 22 nënshkrime për seancë të jashtëzakonshme

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.